

## RELACION

### PËR

#### PROJEKTLIGJIN

#### “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.79/2021 “PËR TË HUAJT””

### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektakti është hartimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.79/2021 “Për të Huaj””.

Projektakti synon të përmirësojë fushën e të drejtave të migrantëve dhe anëtarëve të tyre të familjes, refugjatëve dhe azilkërkuesve, si dhe të mbrojtjes sociale (akses në programe dhe shërbime integrimi), ofrimit më të mirë të informacionit, procedurave të lehtësuara dhe forcimit institucional të ofrimit të shërbimeve për migrantët.

Analiza, vlerësimi dhe hartimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.79/2021 “Për të Huaj””, është kryer duke marrë në konsideratë:

- pajtueshmërinë e dispozitave të LpH me të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kushtetutë dhe Instrumentet Ndërkombëtarë të ratifikuar; në mënyrë të veçantë do të tregohet kujdes për tu siguruar që dispozitat e LpH të jenë në përputhje me parimin e interesit më të mirë të fëmijës, parimin e të drejtës për jetë familjare, parimin e moskthimit, parimin e procedurave të drejta dhe transparente;
- pajtueshmërinë e dispozitave të LpH me *acquis communautaire* në lidhje me menaxhimin e migrimit të rregullt dhe luftën kundër migrimit të parregullt;

- pajtueshmërinë e LpH me objektivat e shtetit shqiptar për të lehtësuar hyrjen dhe qëndrimin e investitorëve dhe turistëve dhe për të luftuar migrimin e parregullt.

Në çdo seksion është synuar të evidentohen problematikat dhe përshtatshmëria me standardet ndërkombëtare dhe ato të BE-së, si edhe do të trajtohen me kujdes rekomandimet/sugjerimet për ndryshime të dispozitave konkrete ose për zbatimin e tyre në praktikë.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektakt nuk është parashikuar në programin analitik të Këshillit të Ministrave për vitin 2024.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Ligji aktual “Për të huajt” Nr. 79/2021 përcakton kriteret e hyrjes, qëndrimit punësimit dhe daljes nga territori të të huajve. Në bazë të hierarkisë së normave ligjore në vend, ky ligj respekton Kushtetutën Shqiptare dhe Konventat Ndërkombëtare të ratifikuara në fushën e të drejtave të njeriut dhe të migrantëve.

Hartimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.79/2021 “Për të Huajt”” vjen si nevojë dhe detyrim i rishikimit të rregullt të ndikimit të akteve ligjore, në mirëqeverisjen e migracionit.

Projektakti i hartuar është bazuar edhe në nevojat dhe problematikat kombëtare, të evidentuara, sipas fushës së përgjegjësisë për çdo institucion.

Projektakti vjen si një element i rëndësishëm në kontekstin kombëtar, për të ndikuar më tej në hapjen e rrugëve të migracionit të rregullt për punësim dhe menaxhimin të hyrjeve të të huajve në kontekstin e turizmit në rritje. Gjithashtu synon të përmirësojë ndjeshëm digjitalizimin e proceseve të migracionit, si një nevojë thelbësore e angazhimeve rajonale.

Projektakti vjen gjithashtu si detyrim i procesit të integrimit evropian, në përputhje me rekomandimet e progres raportit të BE-së dhe synon të adresojë mangësitë e dala nga procesi screening dhe të vijojë punën për harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me *acquis communautaire* dhe Paktin për Migracionin dhe Azilin të BE-së.

Puna për hartimin e projektaktit ka pasur në vëmendje edhe detyrimet e dala nga zbatimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.736, datë 13.12.2023 “Për miratimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës”.

Në këtë drejtim, me ndryshimet e propozuara, projektakti pritet të sjellë:

Përmirësimin e politikave migratore të Shtetit shqiptar, duke lehtësuar shërbimet e migracionit të rregullt nëpërmjet digjitalizimit të plotë të proceseve migratore, veçanërisht lidhur me aplikimin për vizë dhe leje qëndrimi/unike të të huajve. Projektakti ka sjellë lehtësim të kriterëve dhe dokumentacionit të vendosur në ligj, duke reduktuar kërkesat e panevojshme të cilat duhet të rregullohen me akte nënligjore.

Përcaktimin e qartë të autoriteteve përgjegjëse për të huajt, duke përfshirë autoritetet përgjegjëse për integrimin e tyre, qartësimin e të drejtave të të huajve, si dhe detyrimin e të huajve për të respektuar Kushtetutën, ligjet në fuqi dhe vendimet e autoriteteve shtetërore gjatë hyrjes, qëndrimit dhe largimit nga territori i vendit. Autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për përcaktimin e statusit të pashtetësisë dhe lëshimin e dokumentit një personi pa shtetësi, tashmë do të jetë struktura që mbulon çështjet e shtetësisë, azilit dhe të huajve në Ministrinë e Brendshme. Për qëllime udhëtimi jashtë, autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për përcaktimin e statusit të pashtetësisë, sipas kushteve të përcaktuara në konventa ndërkombëtare të njohura nga Republika e Shqipërisë, i lëshon një dokument udhëtimi të huajit pa shtetësi, i cili është banor në Republikën e Shqipërisë, duke i dhënë të drejtën të rikthehet në Republikën e Shqipërisë brenda periudhës së vlefshmërisë. Ky dokument është i vlefshëm për një periudhë 2-vjeçare nga data e lëshimit.

Përmirësime lidhur me dispozitat e Garancisë financiare, e cila është shuma e nevojshme financiare, që depozitohet nga vetë i huaji ose nga garanti për llogari të të huajit, me qëllim që të mbulohen shpenzimet e jetesës dhe pasojat e një dëmi, që

mund të shkaktohet. I Huaji i cili aplikon për vizë, vërteton që ka të ardhura të mjaftueshme financiare nëpërmjet një dokumenti bankar.

Ndryshime lidhur me procedurat e Viza të tipit “A”, e cila është viza tranzit në aeroport. Periudha e vlefshmërisë së vizës “A” do të përfshijë një “periudhë përjashtimi” nga penalteti për tejkalim qëndrimi deri në 15 ditë kalendarike. Si dhe qartësime lidhur me ditët e hyrjes dhe qëndrimit të viza tipi “C”. Periudha e vlefshmërisë së vizës për një hyrje përfshin një "periudhë përjashtimi" nga penalteti për tejkalim qëndrimi prej 15 ditësh kalendarike. Akti administrativ për anulimin e vizës pullë dhe elektronike, si dhe arsyet e nxjerrjes së këtij akti i njoftohen të huajit nëpërmjet sistemit elektronik të vizës ose nëpërmjet komunikimit elektronik nga përfaqësia diplomatike/konsullore e cila ka lëshuar vizën pullë ose elektronike. Kundër aktit administrativ për anulimin e vizës pullë dhe elektronike i huaji ka të drejtën të ankohet në rrugë administrative brenda 5 ditësh pune në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme. Akti rregullon edhe kriteret e lëshimit të vizës pullë dhe elektronike, të cilat mund të refuzohen nëse aplikuesi paraqet dokumente të vendit të origjinës apo rezidencës të falsifikuar, nisur nga rastet e përsëritura të konstatuara dhe diskutuara gjatë procesit të hartimit të projektaktit.

Përmirësimin e kuadrit të politikave migratore në vend, duke përafruar me tej legjislacionin për migracionin me *acquis* të BE-së, në kuadër edhe të Paktit për Migracionin dhe Azilin të BE-së, detyrim i procesit të integritimit në BE, si dhe miratimi paralelisht i normave ndërkombëtare në këtë fushë sipas parashikimeve të konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë.

Disa parashikime të rëndësishme mbi të drejtën e shtetasve të vendeve të Bashkimit Evropian dhe anëtarëve të familjeve të tyre për të lëvizur dhe banuar lirisht brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Shtetasit e BE-së dhe familjarët e tyre përjashtohen nga detyrimi për pajisje me Leje Unike dhe Leje Qëndrimi, duke sjellë harmonizim të plotë me Direktivën 2004/38/EC të BE-së. Propozimi për përjashtimin e tyre nga ky detyrim është në linjë edhe me rekomandimet e lëna në Raportin e Komisionit Evropian për vitin 2023, sipas të cilit, Shqipëria, pavarësisht nivelit të progresit kundrejt rekomandimeve lidhur me lëvizjen e lirë të shtetasve të vendeve anëtare dhe familjarëve të tyre, duhet të vijojë me përforsimin e zbatueshmërisë së ligjit për të huajt në përputhje me Acqui-në e BE-së.

Rishikime lidhur me kategoritë e të huajve që vijnë si studentë apo nxënës shkolle, të cilët pajisen me leje qëndrimi, në përputhje me ndryshimet e fundit të *acquis communautaire*. Po ashtu në linjë me Direktivën (EU) 2016/801 të BE-së, janë lehtësuar kushtet e hyrjes dhe pajisjes me leje qëndrimi për kërkuesit shkencorë. Duke përfshirë dispozita që i japin mundësinë atyre të kenë të drejtë të japin mësim në përputhje me legjislacionin kombëtar.

Garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta dhe Konventat ndërkombëtare të ratifikuara për kategoritë vulnerabël, si VT/VMT dhe fëmijët e pashoqëruar të huaj.

Përmirësimin dhe lehtësimin e kriterëve për akses në tregun e punës duke rishikuar parimet e përgjithshme për punësimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë. Ministria që mbulon çështjet e migracionit të punës tashmë është përgjegjëse për lidhjen e marrëveshjeve për bashkëpunimin bilateral për çështjet e punësimit. Gjithashtu janë shfuqizuar dispozitat e lidhura me vendosjen e kuotave vjetore për pranimin e të huajve në tregun e punës kombëtar.

Lehtësi lidhur me kërkesën për leje unike qëndrimi për një të huaj, e cila mund të bëhet nga vetë i huaji, nga punëdhënësi, agjencia e punësimit ose subjekt i autorizuar (agjenci e licensuar), duke shtuar mundësitë për aplikim. Shqyrtimi i kërkesës dhe lëshimi i lejes unike të qëndrimit është shkurtuar dhe është bërë deri në 4 javë. Kur punëdhënësi punëson një të huaj, njoftimi për autoritetin përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin dhe AKPA-n do të bëhet automatikisht nga sistemi tatimor. Projektakti sanksionon se kërkesa për plotësimin e një vendi të lirë pune duhet të bëhet publike në portalin e shërbimeve të punësimit nga punëdhënësi për një periudhë kohore prej 7 (shtatë) ditësh kalendarike që nga dita e regjistrimit të kërkesës së bërë online për miratimin e punësimit për një shtetas të huaj pranë këtij autoriteti.

Integrimin në ligj të kategorive të reja të të huajve, si psh, një leje të re unike si punëtorë shtëpiak, që i lëshohet një shtetasi të huaj pas miratimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Punëdhënësi duhet të jetë i regjistruar në organet tatimore. Projektakti ka rregulluar më tej edhe dispozitat për Leje Unike për punësim stinor, duke parashikuar se pas vitit të parë të punës, punëdhënësi ka të

drejtë të bëjë kërkesë për të njëjtin të huaj me kusht që periudha e shkëputjes të jetë 6 muaj.

Shfuqizimin e kategorisë leje unike si investitorë. Leja unike e mëparshme për investitorë do të jetë tashmë një leje qëndrimi, e cila nuk do të kërkojë miratim nga AKPA.

Në linjë me zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.736, datë 13.12.2023 “Për miratimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës”, janë harmonizuar më tej një sërë dispozitash të ligjit me aktet evropiane.

Bazuar në nenin 5 pika 3 të direktivës 2021/1883 të BE-së, me qëllim garantimin e të drejtave të parashikuara për punonjësit tepër të kualifikuar është integruar në legjislacion një kriter lidhur me pagën e punonjësit tepër të kualifikuar. I huaji pajiset me leje unike “Kartë blu AL” nëse në kontratën e punës përcaktohet se paga mesatare vjetore bruto është minimalisht 1,0 herë paga mesatare vjetore bruto kombëtare. Gjithashtu, me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit do të përcaktohet lista e profesioneve për të cilat nuk do të aplikohet ky parashikim.

Projektakti ka sjellë më shumë të drejta në lidhje me lejen e qëndrimit të marrë për bashkim familjar dhe lejen autonome, që kanë prekur anëtarët e familjes të personave të pajisur me leje unike si tepër të kualifikuar, në përputhje me direktivat evropiane.

Lufta kundër migrimit të parregullt është edhe një nga kërkesat në kuadër të procesit të aderimit në Bashkimin Evropian, për këtë qëllim projektakti integron dispozita të përmirësuara që kanë të bëjnë me menaxhimin e migracionit të parregullt, veçanërisht të lidhura me Urdhrin e largimit dhe Urdhrin e dëbimit.

Në këtë kontekst kemi një qartësim të mëtejshëm të rasteve për të cilat lëshohet urdhri i dëbimit, veçanërisht kur cenohet siguria publike dhe kombëtare. Deri në përfundimin e procedurës së ankimit, i huaji është i detyruar të qëndrojë në kushtet e masave alternative të mbikëqyrjes ose i ndaluar në qendrën e mbyllur, në pritje të largimit të menjëhershëm, sipas urdhrit të nxjerrë për këtë qëllim.

Projektakti sanksionon se Urdhri i dëbimit si person i padëshiruar i njoftohet në formë të shkruar të huajt kur ndodhet fizikisht në Republikën e Shqipërisë. Nuk lëshohet urdhër dëbimi kur i huaji, subjekt i shpalljes “person i padëshiruar “ nuk ndodhet fizikisht në Republikën e Shqipërisë.

Në një linjë me direktivën evropiane të kthimeve, projektakti ka sanksionuar qartë se familjet në pritje të largimit nga Republika e Shqipërisë, duhet të akomodohen në mjedise të posaçme duke garantuar privatësinë e tyre.

Projektakti ka sjellë përmirësim të të drejtave të lidhura me ndalimin e fëmijëve të pashoqëruar të huaj, duke sanksionuar se përjashtimisht, i mituri i pashoqëruar, i ndaluar mbahet në një qendër sociale për të mitur e hapur posaçërisht për këtë qëllim, nga ose në ambiente dhe qendra të tjera që parashikohen në kuadër të bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare dhe organizata jofitimprurëse që kryejnë misione për fëmijët, ose kategori të tjera individësh në nevojë.

Projektakti ka forcuar më tej edhe dispozitat e lidhura me mbikëqyrjen dhe kontrollin e të huajve, duke parashikuar se ndër të tjera autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin, në zbatim të legjislacionit në fuqi, bashkëpunon dhe kryen inspektime të përbashkëta me strukturat e tjera për kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë nga të huajt gjatë hyrjes dhe qëndrimit të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë. Procedurat mbi inspektimet e përbashkëta do të kryhen sipas urdhrit të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe ministrive përgjegjëse.

Projektakti parashikon se punëdhënësit, që punësojnë një të huaj në Republikën e Shqipërisë janë të detyruar të ruajnë, të paktën për kohëzgjatjen e punësimit, kopjet ose regjistrat, si dhe evidenca mbi respektimin e të drejtave të punëmarrësve të huaj që burojnë nga legjislacioni i punës, të gatshëm për inspektim nga autoritetet përgjegjëse shtetërore për kontrollin e të huajve në territor, si dhe të inspektoratit përgjegjës për punësimin.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektakti është në përputhje të plotë me nenit 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Ky projektakt synon përafrimin me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe më konkretisht me:

**Direktivën (BE) 2016/801** të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 maj 2016, “Mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllime kërkimi, studimesh, trajnimesh, shërbimi vullnetar, skemash të shkëmbimit të nxënësve ose projekteve arsimore dhe au pairing”. Numri CELEX 32016L0801, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 132, datë 21.5.2016, f. 21–57. (amenduar me Direktivën 2021/1883).

**Direktivën 2004/38/KE** të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 29 prill 2004, “Mbi të drejtën e qytetarëve të Bashkimit dhe anëtarëve të familjes së tyre për të lëvizur dhe për të qëndruar lirshëm brenda territorit të shteteve anëtare, që ndryshon Rregulloren (KEE) nr. 1612/68 dhe që shfuqizon direktivat 64/221/KEE, 68/360/KEE, 72/194/KEE, 73/148/KEE, 75/34/KEE, 75/35/KEE, 90/364/KEE, 90/365/KEE dhe 93/96/KEE”, e ndryshuar”.

Numri CELEX 32004L0038.

Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 168, datë 30.4.2004, f. 77–123.

**Direktivën (BE) 2024/1233** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 24 prill 2024 “Mbi një procedurë të vetme aplikimi për një leje të vetme për shtetasit e vendeve të treta për të qëndruar dhe punuar në territorin e një Shteti Anëtar dhe për një grup të përbashkët të drejtash për punëtorët e vendeve të treta që banojnë ligjërisht në një shtet anëtar.” (reformular).

**Direktivën (BE) 2021/1883** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 tetor 2021 “Mbi Kushtet e Hyrjes dhe Qëndrimit të Shtetasve të Vendeve të Treta për Qëllime Punësimi me Kualifikim të Lartë.” (shfuqizon Direktivën e Këshillit Evropian 2009/50/EC).



**Direktivën e Këshillit 2003/86/KE**, datë 22 shtator 2003, “Mbi të drejtën e bashkimit familjar”. Numri CELEX 32003L0086, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 251, datë 3.10.2003, faqe 12–18.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektakti përbëhet nga 59 nene, me përmbajtjen e mëposhtme.

**Neni 1**, sjell ndryshime lidhur me përkufizimet e Dëbimit dhe Largimit, si dhe urdhërit për shpallje person i padëshiruar. Gjithashtu edhe përmirësime lidhur me përkufizimin persona vulnerabël, punësimin me me kualifikim të lartë, Shtetas i një vendi të tretë, investitorë, i vetëpunësuar dhe punëtor shtëpie.

**Neni 2**, sjell disa shtesa dhe ndryshime të lidhura me autoritetet përgjegjëse për trajtimin e të huajve.

**Neni 3**, ku përcaktohen kriteret të përgjithshme për hyrjen, daljen dhe kalimin transit, ku është integruar edhe qëndrim i njëanshëm i shprehur me vendim të Këshillit të Ministrave”.

**Neni 4**, përfshin autoritetin shtetëror qendror përgjegjës për përcaktimin e statusit të pashtetësisë, në lëshimin e një dokument udhëtimi të huajt pa shtetësi, i cili është banor në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 5**, përcakton se në nenin 13, në pikën 2, togfjalëshi “autoritetet rajonale” zëvendësohet nga “autoriteti vendor”.

**Neni 6**, sjell disa ndryshime në nenin 18 bëhen këto shtesa dhe ndryshime: Pika 1 ndryshon si vijon: “1. I Huaji i cili aplikon për vizë, vërteton që ka të ardhura të mjaftueshme financiare nëpërmjet një dokumenti bankar. Në pikën 2, fjala “depozitohet” zëvendësohet me fjalën “vërtetohet”; Në pikën 4, fjalët “e depozitimit dhe kthimit të garancisë financiare” shfuqizohen.

**Neni 7**, parashikon se më titullin e seksionit 1, pas termit “vizave” shtohet togfjalëshi “dhe afatet”.

**Neni 8**, ndryshon titullin e nenit 19, duke e bërë Llojet e vizave. Gjithashtu parashikon periudha e vlefshmërisë së vizës “A” do të përfshijë një “periudhë përjashtimi” nga penaliteti për tejkalim qëndrimi deri në 15 ditë kalendarike.

**Neni 9**, sjell ndryshime për tipin e vizën C, përfshirë një "periudhë përjashtimi" nga penaliteti për tejkalim qëndrimi prej 15 ditësh kalendarike.

**Neni 10**, parashikon se në nenin 21 në pikat 1 dhe 2, pas fjalëve “me leje qëndrimi” shtohen fjalët “leje unike”.

**Neni 11**, sjell ndryshime të lidhura me kërkesën për vizë, duke përfshirë faktin që aplikimi për vizë nga i huaji bëhet jo më shumë se 90 ditë përpara datës së planifikuar për të ardhur në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet sistemit elektronik të vizave.

**Neni 12**, parashikon se Akti administrativ për anulimin e vizës pullë dhe elektronike, si dhe arsyet e nxjerrjes së këtij akti i njoftohen të huajit nëpërmjet sistemit elektronik të vizës ose nëpërmjet komunikimit elektronik nga përfaqësia diplomatike/konsullore e cila ka lëshuar vizën pullë ose elektronike. Kundër aktit administrativ për anulimin e vizës pullë dhe elektronike i huaji ka të drejtën të ankohet në rrugë administrative brenda 5 ditësh pune në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme.

**Neni 13**, sjell ndryshime lidhur me refuzimin e vizës pullë dhe elektronike, duke integruar rastet kur paraqiten dokumente të vendit të origjinës apo rezidencës të falsifikuar. Pas refuzimit të vizës pullë dhe elektronike, i huaji ka të drejtë të riaplikojë vetëm pasi të ketë mbyllur procedurat e ankimit dhe të jetë vlerësuar pozitivisht. Në rast se vlerësimi është negativ, ka të drejtë riaplikimi pasi të kenë kaluar tre muaj nga data e marrjes së vendimit për refuzim.

I huaji, i pajisur me vize të tipit D si dhe i huaji i cili nuk ka nevojë për vizë me motiv qëndrimi aplikojnë online për leje qëndrimi.

**Neni 15**, parashikon integrimin e një neni të ri 33/1, mbi të drejtën e shtetasve të vendeve të Bashkimit Evropian dhe anëtarëve të familjeve të tyre për të lëvizur dhe banuar lirisht brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Shtetasit e vendeve të Bashkimit Evropian kanë të drejtën e qëndrimit në territorin e RSH, pa leje qëndrimi apo leje unike, për periudha qëndrimi më të gjata se tre muaj.

Kur anëtarët e familjes së një shtetasi të Bashkimit Evropian, nuk janë shtetas të Bashkimit Evropian, pajisen me “Kartëqëndrimi i një anëtari të familjes së një shtetasi të BE-së”.

**Neni 16**, parashikon se në gërmën “gj”, shtohet nënkategoria xiii me këtë përmbajtje: “xiii) leje unike për punëtor shtëpie.” Si dhe shtohet gërma “k” me këtë përmbajtje: “k) leje qëndrimi për investitor”.

**Neni 17**, përcakton se në nenin 41, bëhen këto shtesa dhe ndryshime: Pas pikës 2, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje: “3. Leja e qëndrimit për anëtarët e familjes së të huajit të pajisur me kartë blu AL, lëshohet për herë të parë për një periudhë

vlefshmërie të njëjtë me afatin e kartës blu.”; Pikat 3, 4, 5, 6 dhe 7, bëhen pikat 4, 5, 6, 7 dhe 8.

**Neni 18**, sjell disa të drejta të reja lidhur me anëtarët e familjes së të huajit të pajisur me kartë blu AL.

**Neni 19**, sjell ndryshime në nenin 46, ndryshon lidhur me Lejen e qëndrimit për studentë.

**Neni 20**, sjell ndryshime lidhur me Lejen e qëndrimit për nxënësit e shkollës.

**Neni 21**, shfuqizon pikat 3, 4 dhe 5, në nenin 48.

**Neni 22**, sjell ndryshime në nenin 50 lidhur me lejen e qëndrimit për kërkim shkencor.

**Neni 23**, sjell ndryshime në nenin 51. Paragrafi i dytë i pikës 3, dhe pika 4 shfuqizohen; Në pikën 5, fjala “...shans...” zëvendësohet me fjalën “...mundësi...”.

**Neni 24**, përcakton se në nenin 53, pikat 5 dhe 7, ndryshojnë si më poshtë:

“ 5. Gjatë periudhës së rehabilitimit dhe reflektimit, viktimat ose viktimat e mundshme të trafikimit gëzojnë të gjitha të drejtat dhe shërbimet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

7.I huaji me statusin e viktimës apo viktimës së mundshme të trafikimit, ka të drejtën e punësimit pa marrë më parë miratim nga AKPA në bashkepunim me Ministrinë e Brendshme.”

**Neni 25**, përcakton se në nenin 54, pika 1, riformulohet si vijon: “1. Kërkesa për të vërtetuar nëse aplikanti është person pa shtetësi i paraqitet autoritetit përgjegjës për shtetësinë, azilin dhe të huajt në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.”

**Neni 26**, sjell ndryshime lidhur me parimet e përgjithshme për punësimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë. “Lidhja e marrëveshjeve për bashkëpunim bilateral mbi migracionin e punës është në kompetencë të Ministrisë që mbulon çështjet e Migracionit të punës dhe AKPA. Kërkesa për leje unike qëndrimi për një të huaj mund të bëhet nga vetë i huaji, nga punëdhënësi, agjensia e punësimit ose nga subjekti i autorizuar agjenci e licensuar. Shqyrtimi i kërkesës dhe lëshimi i lejes unike të qëndrimit, kur plotësohen kriteret e kërkuara nga legjislacioni në fuqi, bëhet brenda 4 javësh nga dita e aplikimit. Kur punëdhënësi punëson një të huaj, njoftimi për autoritetin përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin dhe autoriteti përgjegjës për punësimin dhe aftësitë bëhet automatikisht nga sistemi tatimor.

**Neni 27**, përcakton se në nenin 58,

1. Pika 3, shfuqizohet;

2. Pika 4, ndryshon si vijon: “4. Pas vitit të parë të punës, punëdhënësi ka të drejtë të bëjë kërkesë për të njëjtin të huaj me kusht që periodha e shkëputjes të jetë 6 muaj.”;
3. Në pikën 6, fjalët “...vendeve të Bashkimit Evropian...” shfuqizohen.

**Neni 28**, sjell ndryshime lidhur me Lejen unike për punonjës me kualifikim të lartë “Karta blu AL”. I huaji pajiset me leje unike “Kartë blu AL” nëse në kontratën e punës përcaktohet se paga mesatare vjetore bruto është minimalisht 1,0 herë paga mesatare vjetore bruto kombëtare. Lista e profesioneve për të cilat nuk aplikohet pika 3 e këtij neni përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit dhe ministrit përgjegjës për financat.”

**Neni 29**, përcakton se në nenin 68,

1. Gërma “d”, ndryshon si vijon: “d) zotëron një certifikatë/dëshmi penaliteti nga vendi i tij i origjinës dhe ne vendin ku është rezident.”;
2. Shtohet gërma “e” me këtë përmbajtje: “e) Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin, verifikon dokumentacionin e vlefshëm nëse i përmbush kriteret ligjore, për të hyrë dhe qëndruar në RSH, duke marrë parasysh vetëdeklarimin për këtë kategori dhe dokumentacioni origjinal përkatës dorëzohet pas miratimit të lejes unike të qëndrimit.”.

**Neni 30**, integron një leje të re unike për Punëtor Shtëpie.

**Neni 31**, përcakton se në nenin 72, pas gërmës “e”, fjalia “Në këtë rast, punëdhënësi informon brenda 2 javëve autoritetet përgjegjëse ku i huaji është pajisur me lejen unike.” Zëvendësohet me fjalinë “Në rastet e largimit të të huajit, njoftimi për autoritetin përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin dhe autoritetin përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, bëhet automatikisht nga sistemi tatimor.”

**Neni 32**, sjell ndryshime në nenin 74 lidhur miratimin e punësimit të një të huaji.

**Neni 33**, sjell ndryshime në nenin 75, lidhur me refuzimin e miratimit të Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi për punësimin e një të huaji.

**Neni 34**, sjell ndryshime lidhur me përparësinë në miratimin e punësimit.

**Neni 35**, shfuqizon Nenet 78 dhe 79 të lidhura me Tregun e punës dhe kuotat vjetore të punësimit të të huajve dhe Përrjashtimin nga kuotat vjetore të punësimit.

**Neni 36**, sjell ndryshime në nenin 80 lidhur me përjashtimin nga detyrimi për miratimin për punësim nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive. Deklarimi për punësimin tashmë do të bëhet online nëpërmjet portalit e-albania në seksionin aplikim për leje unike

**Neni 37**, sjell përmirësime në përcaktimin e afateve për pajisen me leje unike për kategori të veçanta, për një qëndrim më shumë se 90 ditë.

**Neni 38, përcakton se** në nenin 82, pika 2, ndryshon si vijon: I huaji i pajisur me leje unike është i detyruar të njoftojë autoritetet përgjegjëse për çdo ndryshim të kushteve mbi të cilat është lëshuar leja unike dhe të kërkojë miratimin nga autoriteti përgjegjës për punësimin dhe aftësitë dhe autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin, në rast se ndryshimi lidhet me:

a) emrin dhe adresën e punëdhënësit;

b) kontratën e vlefshme të punës që mbulon kohën për të cilën është lëshuar leja unike;

c) aktivitetet e autorizuara si person i punësuar.”.

**Neni 39**, parashikon se në nenin 85, gërmat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, të pikës 2, shfuqizohen.

**Neni 40**, shton një nen të ri 85/1 Leje qëndrimi për investitorë.

**Neni 41, parashikon se** në nenin 86, pika 1, fjalët “...struktura përgjegjëse për të huajt...” zëvendësohet me fjalët “...autoriteti përgjegjës për çështjet e migracionit...”.

**Neni 42, parashikon se** në nenin 99, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Titulli ndryshon dhe bëhet: “Urdhri i largimit dhe afati i ekzekutimit vullnetar”
2. Fjala e parë e pikës 7, riformulohet: “7. I huaji të cilit i është miratuar zgjatja e periudhës së ekzekutimit të urdhrin të largimit ka të drejtë:..”

**Neni 43**, sjell përmirësime në nenin 101, lidhur me ekzekutimin vullnetar i urdhrin të largimit.

**Neni 44**, sjell ndryshime në Nenin 102 lidhur me Dëbimin e të huajt nga autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin.

**Neni 45**, ndryshon nenin 103, lidhur me Ankimin kundër urdhrin të dëbimit.

**Neni 46**, përcakton se në nenin 105, bëhen shtesa dhe ndryshime. Nuk lëshohet urdhër dëbimi kur i huaji, subjekt i shpalljes “person i padëshiruar “ nuk ndodhet fizikisht në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 47 përcakton se** titulli i nenit 106 ndryshon dhe bëhet: “Ekzekutimi i urdhrin të dëbimit”.

**Neni 48, përcakton se** në nenin 108, në fund të fjalisë, pas fjalës “...urdhrin” shtohet fjala “.../urdhrit.”.

**Neni 49, përcakton se** titulli i sesionit IV ndryshon dhe bëhet: “Masat e përkohshme dhe zëvendësimi i tyre”.

**Neni 50**, përcakton se në nenin 109 bëhen ndryshime. Shtohet pika 4 me këtë përmbajtje: “4. Deklarimi i të huajit, subjekt dëbimi, për t’u larguar vullnetarisht nga Republika e Shqipërisë, mund të merret në konsideratë nga autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin me qëllim zëvendësimin e masës nga “urdhër dëbimi” në “urdhër largimi”, përjashtuar rastet kur për interesa të rendit publik dhe sigurisë kombëtare ky deklarim nuk mund të merret në konsideratë. Në të gjitha rastet e trajtimit të kërkesave për zëvendësim të këtyre masave vihet në dijeni autoriteti qendror shtetëror përgjegjës për trajtimin e të huajve dhe kthimet.”

**Neni 51**, sjell disa ndryshime lidhur me ndalimin në qendrën e mbyllur.

**Neni 52**, sjell ndryshime në nenin 117 ku rregullohet Periudha e ndalimit në qendër të mbyllur.

**Neni 53**, sjell ndryshime në nenin 118 lidhur me revokimin e urdhrit të ndalimit në qendër.

**Neni 54**, sjell ndryshime në nenin 119 lidhur me ndalimin e të miturve të pashoqëruar.

**Neni 55**, sjell ndryshime në nenin 127 lidhur me kontrollin e të huajve.

**Neni 56**, sjell ndryshime në Nenin 134 Detyrimet për punëdhënësin.

**Neni 57**, sjell ndryshime në nenin 140 për tarifatat shtetërore për lëshimin e vizës, lejes së qëndrimit dhe lejes unike.

**Neni 58** sjell ndryshime në nenin 141 mbi masat ndëshkimore dhe ekzekutimi i tyre.

**Neni 59**, përcakton se ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Me zbatimin e këtij projektakti ngarkohen institucionet që kanë detyrime ligjore të përcaktuara në të.

## **VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ky projektakt është hartuar nga Grupi Ndërinstitucional i Punës i ngritur me Urdhrin e Kryeministrit nr.114, datë 16.7.2024 “Për ngritjen dhe funksionimin e Grupit Ndërinstitucional të Punës për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.79/2021, “Për të huajt”””.

---

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.79/2021 “Për të huajt”””.

Grupi Ndërinstitucional i Punës, nën drejtimin e zëvendësministrit të Brendshëm, përgjegjës për fushën e migracionit, ka zhvilluar dy takime me qëllim koordinimin e procesit dhe hartimin e projektligjit. Takimet janë zhvilluar në ambientet e Ministrisë së Brendshme në datat 19 dhe 29 gusht 2024. Me qëllim finalizimin e këtij projektakti GNP ka përdorur një metodologji të dakordësuar për rishikimin e Ligjit nr. 79/2021 "Për të huajt".

Në takimet e Grupit Ndërinstitucional të Punës, kanë marrë pjesë anëtarët e GNP-së, si dhe janë ftuar dhe kanë marrë pjesë ekspertë të organizatave ndërkombëtare apo ekspertë të jashtëm, sipas nevojave që lidheshin me hartimin e këtij projektligji.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektakti nuk ka efekte financiare për buxhetin e shtetit.

**MINISTRI**

**Ervin Hoxha**

*Konceptoi: A.Haxhi I.Hodaj A.Toma*

*Miratoi: S.Banushi*

*E. Lala*

*M.Cuka*

*Konfirmoi: A.Mahila*